

BULETINI I IGJK-së Tetor 2006

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës rreth veprimtarisë së Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK). Ky publikim iu është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK-së tani përmban artikuj në lidhje me çështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

Sali Mekaj Gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Pejë

PARASHKRIMI I EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE PLOTËSUESE DHE I MASAVE TË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

HYRJE

Parashkrimi i ndjekës penale dhe parashkrimi i ekzekutimit të sanksioneve penale paraqet shuarje të së drejtës së organeve shtetërore për ndjekje penale të kryesve të veprave penale dhe për ekzekutim të sanksioneve penale të shqiptuara me aktgjykim të formës së prerë, për shkak të kalimit të kohës.

Kështu pas skadimit të kohës së caktuar ndjekja penale dhe ekzekutimi i sanksioneve penale bëhen jo lëndore dhe në këtë mënyrë suspendohet zbatimit i Kodit Penal, por nuk ekziston më as e drejta procedurale për ndjekje penale e as për ekzekutim të sanksionit të shqiptuar penal, vetëm për shkak të ndikimit të efektit të kohës dhe mosveprimit të organit të caktuar brenda afateve të arsyeshme kohore.

Për çështjen e parashkrimit të ndjekjes penale dhe ekzekutimit të sanksioneve penale Kodi Penal i Kosovës ka parashikuar kushte dhe afate kohore

brenda të cilave organet e drejtësisë janë të obliguara dhe të autorizuar të veprojnë në drejtim të ndjekjes penale të kryesve të veprave penale, poashtu edhe për ekzekutimin e sanksioneve penale. Pra, në këtë drejtim ato janë të obliguara të veprojnë ex lege, kështu që këtu nuk vihet në shprehje vullneti i personit kundër të cilit zbatohet ndjekja penale, apo kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal. Ata nuk mund të heqin dorë nga efekti i ndalimit të ndjekjes penale dhe zbatimit të sanksioneve penale.

Kodi Penal i Kosovës e ka rregulluar në mënyrë të veçante parashkrimin e ekzekutimit të sanksioneve penale duke i përcaktuar afatet kohore të cilat varen nga gjatësia kohore e dënimit të shqiptuar, nëse është fjala për dënimin me burgim afatgjatë dhe me burgim, si dhe për dënimin me gjobë pavarësisht nga lartësia e gjobës.

PARASHKRIMI I EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE PLOTËSUESE

Ndërkaq, kur është fjala për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm ligjdhënës ka parashikuar afate të veçanta kohore që nuk janë të bazuara në kohën e zgjatjes së dënimit plotësues të shqiptuar me aktgjykim apo aktvendim të plotfuqishëm.

Është e njohur se të gjitha dënimet plotësuese të parashikuara me nenin 54 të KPPK të Kosovës, mund të shqiptohen vetëm së bashku me dënimet kryesore dhe me dënimet alternative dhe kurrsesi si dënime të veçanta, përveç dënimit me gjobë që mund të shqiptohet edhe si dënim kryesor dhe si dënim plotësues. Ne rastet kur shqiptohet si dënim plotësues, shqiptohet krahas dënimit kryesor ose alternativ.

E veçanta e dispozitës se nenit 93 të KPPK, me të cilën rregullohet çështja e parashkrimit të dënimeve plotësuese dhe i masave të trajtimit të detyrueshëm është se këto dënime dhe këto masa, me përjashtim të dënimit me gjobë, për të cilin është parashikuar afat i njëjtë i parashkrimit, sikur se në rastet kur shqiptohet si dënim kryesor, janë parashikuar afate të veçanta të cilat nuk e përcjellin fatin e afateve të parashkrimit të dënimit kryesor.

Kështu, kemi situatën kur me të njëjtin aktgjykim të formës së prerë është shqiptuar dënimi kryesor së bashku me një nga dënimet plotësuese dhe afati i parashkrimit të dënimit kryesor është më

i shkurtër se sa afati i parashkrimit të dënimit plotësues dhe anasjelltas, afati i parashkrimit të dënimit plotësues është më i shkurtër se afati i parashkrimit të dënimit kryesor.

E veçanta tjetër e parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve plotësuese, duke përjashtuar dënimin me gjobë është se afati i parashkrimit të dënimit plotësues ndonjëherë përputhet me afatin e dënimit plotësues, por ndonjëherë këto afate nuk përputhen. Kështu, nëse një kryesi të veprës penale i është shqiptuar dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik në kohëzgjatje prej pesë vjetësh sipas nenit 56 par.1 të KPPK, atëherë, ai afat përputhet plotësisht me afatin për parashkrimin e këtij dënimi, por në rastin kur si dënim plotësues është shqiptuar heqja e të drejtës për tu zgjedhur nga neni 55, atëherë afati i parashkrimit të këtij dënimi plotësues është më i gjatë se afati i zgjatjes së dënimit që mund të shqiptohet, pasi ky dënim nuk mund të shqiptohet për afat me të gjatë se tre vjet.

Pra, kur është fjala për parashkrimin e dënimeve plotësuese nga neni 54 par.2 të KPPK, me përjashtim të dënimit me gjobë, sipas nenit 93 par.2 të KPPK, afati i parashkrimit është pesë vite nga dita e aktgjykimit me të cilin ky dënim bëhet i plotfuqishëm, pavarësisht nga kohëzgjatja e dënimit të përcaktuar me aktgjykim për shqiptimin e këtij dënimi.

AFATI I FILLIMIT TË PARASHKRIMIT TË DËNIMEVE PLOTËSUESE

Çështje e veçantë për të cilën mendoj se vlen të trajtohet është se nga cili moment fillon të ec afati i parashkrimit të dënimeve plotësuese. Me përjashtim të dënimit me gjobë, dënimet plotësuese - marrja e sendit dhe urdhrin për publikimin e aktgjykimit të cilat nuk janë të diskutueshme dhe ato rrjedhin nga dita kur aktgjykimi me të cilin janë shqiptuar të behët i plotfuqishëm, pavarësisht së me çfarë dënimi është gjykuar kryesi i veprës së caktuar penale.

Sipas paragrafit 2 të nenit 93 të KPPK është përcaktuar si afat i parashkrimit të dënimeve plotësuese; afati prej pesë vitesh nga dita kur aktgjykimi me të cilin janë shqiptuar këto dënime të bëhet i plotfuqishëm. Mirëpo, me qenë se dënimet e parashikuara me nenin 54 par.2 pika 2, 3, 4, 5, 6 dhe 9 të KPPK, sipas nenit 63 par.2 mund të ekzekutohen vetëm pas mbajtjes së dënimit me burgim, atëherë afati i parashkrimit nuk fillon nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit sepse dënimi plotësues hyn në fuqi pas mbajtjes së dënimit dhe nga kjo datë duhet llogaritur afatin e parashkrimit me skadimin e të cilit dënimi plotësues nuk mund të ekzekutohet. Zakonisht edhe në aktgjykimet për shqiptimin e dënimeve plotësuese përcaktohet se dënimi plotësues do të zbatohet pas vuajtjes së dënimit.

Mirëpo, edhe në këto raste është problematike që të caktohet data e fillimit të ecjes së afatit të parashkrimit, sepse, nëse një person është gjykuar në

dënim burgu në kohëzgjatje prej pesë vitesh dhe ai është dërguar në vuajtjen e dënimit, por në ndërkohë është liruar nga vuajtja e dënimit me kusht, apo si rezultat i zbutjes së dënimit, faljes ose amnestis, atëherë mendoj se në këto raste afati duhet të llogaritet nga dita e lirimt nga vuajtja e dënimit e jo nga dita e skadimit të afatit të dënimit të përcaktuar me aktgjykim, sepse edhe në dispozitën e paragrafit 2 të nenit 63 të KPPK, thuhet se ekzekutimi i dënimit plotësues fillon pas mbajtjes së dënimit me burgim.

Siç mund të shihet nga ajo që u tha më lartë, kjo vlen vetëm për dënimet plotësuese që janë shqiptuar së bashku me dënimin me burgim afatgjatë ose me burgim, por jo edhe për dënimet tjera, siç janë dënimi me kusht dhe dënimi me gjobë, sepse në këto raste afati i parashkrimit ec nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit.

Çështje e veçante është nëse dënimi plotësues është shqiptuar së bashku me dënimin alternativ-gjysmë liria, se nga kur fillon afati për ekzekutimin e dënimit plotësues dhe nga cila datë fillon afati i parashkrimit të dënimit plotësues, pasi në këtë rast i gjykuari një kohë të ditës e kalon në burg, ndërsa pjesën tjetër e kalon në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme të përditshme apo aktiviteteve që i ka caktuar gjykata. Mendoj se ky rast paraqet përjashtim dhe në këtë rast duhet llogaritur afatin e parashkrimit nga dita kur aktgjykimi me të cilin është shqiptuar është bërë i plotfuqishëm dhe jo nga momenti i vuajtjes së dënimit, sikur të rastet kur dënimi plotësues është

shqiptuar së bashku me dënimin me burgim. Sa për ilustrim po përmend

rastin nëse një person është gjykuar me gjysmë liri për shkak të një veprë penale të rrezikimit të trafikut publik, pasi gjykata ka vlerësuar se ai është i punësuar dhe nga ajo punë mban familjen e tij kështu që është urdhëruar që ai gjatë ditës të jetë në punë, ndërsa gjatë natës të shkoj në vuajtje të dënimit, mirëpo krahas këtij dënimi i është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi

i drejtimit të automjetit në afat prej tri vitesh, atëherë konsideroj se në këtë rast dënimi plotësues mund të ekzekutohet nga dita e plotfuqishmërisë, pavarësisht se i gjykuari është në vuajtje të dënimit me gjysmë liri, sepse ky dënim edhe pse i shqiptuar si dënim me burg është urdhëruar që të zbatohet duke e kaluar vetëm një pjesë të kohës në burg, pra dallon nga dënimi i shqiptuar me burg.

PARASHKRIMI I ZBATIMIT TË MASAVE TË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

Lidhur me parashkrimin e masave të trajtimit të detyrueshëm, mendoj se ligji është i qartë dhe këto masa nuk mund të ekzekutohen pas skadimit të afatit prej tri vitesh nga dita kur aktgjykimi për shqiptimin e kësaj mase është bërë i formës së prerë pavarësisht se a është fjala për masë të trajtimit të detyrueshëm me ndalim, apo nga liria siç është parashikuar me nenin 4 dhe 5 të Rregullores nr.2004/34 mbi procedurën

penale ku parashihen kryes me çrregullime mendore. Në rastet kur një masë e tillë është shqiptuar krahas dënimit me burgim, atëherë kjo mase parimisht duhet zbatuar para vuajtjes së dënimit dhe e njëjta llogaritet me dënimin e shqiptuar, kështu që nuk ka arsye për pritje për zbatimin e këtyre masave dhe së kendejmi nuk ka as paqartësi për fillimin e afatit të parashkrimit të tyre.

NDALIMI DHE NDËRPRERJA E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE PLOTËSUESE DHE MASAVE TË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

Dispozita e nenit 93 nuk i ka përcaktuar kushtet për ndaljen dhe ndërprerjen e afatit të parashkrimit në mënyrë të veçantë. Mendoj se dispozita e nenit 94 të KPPK duhet zbatuar përshtatshëm

edhe kur është fjala për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve plotësuese, pavarësisht nga natyra dhe qëllimi i shqiptimit të këtyre dënimeve.

Ngjarjet e ardhshme nëntor 2006

Trajnim i shkathtësive praktike: Simulimi i gjykimit

Grupi përfitues: Gjyqtarët e lëmisë civile
IGJK do të organizoj një simulim praktik të një gjykimi për gjyqtarët e lëmisë civile të

rajonit të Prishtinës . Në këtë simulim është përzgjedhur një rast problematik nga praktika gjyqësore, i cili do të nxisë pjesëmarrësit të diskutojnë për problemet e

parashtruara dhe që ndërlihen me punën praktike të tyre.

Data e planifikuar: 02 nëntor 2006

Seminar, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit të Prizrenit.*

IGJK do të vazhdoj trajnimet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rajonin e Prizrenit. Ky do të jetë sesion dy-ditor i cili mëton që të jap një pasqyrim të detajuar drejt zbatimit të dispozitave të neneve 5 dhe 6 të kësaj konvente, me qëllim të ngritjes së njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës drejt praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tetë trajnues vendor, gjyqtar dhe prokuror të cilët janë çertifikuar nga Këshilli i Evropës do të veprojnë në cilësinë e trajnuesve në këtë sesion.

Data e planifikuar: 03 dhe 04 nëntor 2006.

Tryezë diskutimesh: Mbrojtja e viktimave të trafikuar

Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët
Qëllimi kryesor i kësaj tryeze është që të prezantohen dhe të analizohen problemet e praktikës gjyqësore, sidomos për masat për parandalimin e kësaj dukurie, mbrojtjen e dhe të drejtat e viktimave në procedurën penale etj.

Data e planifikuar: 07 nëntor 2006

Seminar për gjyqtarë porotë në rajonin e Gjilanit

Grupi përfitues: Gjyqtarët porotë

IGJK-ja në bazë të mandatit që ka dhe në kuadër të organizimit të trajnimeve për gjyqtarë porotë nëpër rajonet e Kosovës kësaj radhe do të organizoj seminarin për gjyqtarë porotë të rajonit të Gjilanit. Trajnimi do të përqendrohet në aspektin praktik të zhvillimit të procedurave penale dhe civile ku shprehet roli i gjyqtarëve porot dhe përfshinë edhe disa aspekte të Kodit të etikës.

Data e planifikuar: 09 nëntor 2006

Trajnim i shkathtësive praktike: Simulim Grupi përfitues: Prokurorët dhe gjyqtarët e lëmisë penale

IGJK do të organizoj një simulim praktik për prokurorët dhe gjyqtarët e lëmisë penale të rajonit të Mitrovicës. Këtë radhë është përzgjedhur një rast lidhur me seancën degjimore për caktimin e paraburgimit. Pjesëmarrësit pas simulimit do të diskutojnë për problemet me të cilat po ballafaqohen me qëllim të harmonizimit të praktikës.

Data e planifikuar: 15 nëntor 2006

Seminar nga e drejta administrative

Grupi përfitues: Gjyqtarët e lëmis civile

Seminari kryesisht do të përqendrohet në konfliktin administrativ, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese në procedurën e konfliktit administrativ, padinë në konfliktin administrativ, Aktin administrativ si objekt i konfliktit administrativ dhe praktikën gjyqësore ku shprehen vështirësi të ndryshme me qëllim të eliminimit të tyre.

Data e planifikuar: 17 nëntor 2006

Seminar - E drejta sendore - Pronësia

Grupi përfitues: Gjyqtarët e lëmisë civile

Temat të cilat do të shtjellohen gjatë punës së seminarit kryesisht do të përqendrohen në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e parablerjes në paluajtshmëri, fitimin e së drejtës së pronësisë në paluajtshmëri mbi bazën më të fortë juridike, pengimin në posedim tek servitutet sendore, fitimin e servitutit sendor në bazë të posedimit etj.

Data e planifikuar: 21 nëntor 2006

Tryezë diskutimesh- Interpretimi, udhëheqja e rasteve dhe udhëheqja në gjykatore,

Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe Prokurorët

IGJK në bashkëpunim me Këshillin e Evropës do të organizojë një tryezë diskutimesh e cila do të fokusohet në çështjet lidhur me interpretimin, udhëheqjen

e rasteve dhe të seancave gjyqësore. Me këtë rast në cilësi të trajnuesve do të jenë ekspert të jashtëm të cilët duke paraqitur praktikat më të mira lidhur me këto çështje do të kenë mundësi që të përcjellin tek pjesëmarrësit njohuri të cilat do t'i ndihmojnë ata në punën e tyre praktike.

Data e planifikuar: 23 nëntor 2006

Tryezë diskutimesh – hartimi i vendimeve gjyqësore

Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe Prokurorët

Në këtë sesion trajnues IGJK dhe Këshilli i Evropës do të organizojnë një tryezë të diskutimeve ku çështje kryesore e trajtimit do të jetë hartimi i vendimeve gjyqësore. Edhe me këtë rast në cilësi të ekspertëve do të jenë gjyqtarë të jashtëm. Në fokus të kësajë tryeze do të jenë teknikat dhe format bashkëkohore të hartimit të vendimeve gjyqësore me qëllim që edhe gjyqtarët e Kosovës të jenë në hap me gjyqësinë

ndërkombëtare. *Data e planifikuar: 24 nëntor 2006*

Tryezë diskutimesh për Kodin e Etikës

Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët e regjionit të Prishtinës.

IGJK-ja në kuadër të aktiviteteve trajnuese nëpër rajonet e Kosovës do të organizoi një tryezë të diskutimeve lidhur me Kodin e Etikës. Kësaj radhe përfitues të këtij trajnimi do të jenë gjyqtarët dhe prokurorët nga rajoni i Prishtinës. Ky trajnim do të këtë për qëllim që të jap një pasqyrim më të detajuar mbi përvojën dhe praktikën, ku element i veçant i diskutimit do të jetë pavarësia e gjyqtarit. Trajnimi do të përqëndrohet në pozitën e gjyqtarit si vendimmarrës i vetëm apo në kolegji.

Data e planifikuar: 30 nëntor 2006